



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-10015/22 datë:19.04.2022



Npi – 01/93 datë: 29.04.2022

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) nenin, 17 pika (f) si dhe nenin 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087; Si dhe duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit të Komunës Nr.02/123 të datës: 20.04.2022, dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 29.04.2022, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR K.R.M.
“PASTËRTIA” SH.A - NJËSIA NË SHTIME

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 29.04.2022, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A - Njësia në Shtime.

Neni 2

Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia”- SH.A, njësia në Shtime, në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, do t'i ketë 3 antar: 1(një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtar të tjerë të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, është si vijon:

1. Bedri Zeqiri, - Rr. “Nënë Tereza” Nr.40 Shtime, (i emëruar nga Kryetari i Komunës)
2. Bajram Hajrizi - Rr. “Besa Besë” Nr.2B Reçak, (i zgjedhur nga Kuvendi)
3. Besnik Seferi - Rr. “Qamëria” Nr.169 Lagja e Pajtim, (i zgjedhur nga Kuvendi)

Neni 4


- 4.1 Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.
- 4.2 Komisioni Komunal i Aksionarëve i raporton Kuvendit Komunal në bazë vjetore.
- 4.3 Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal i Aksionarëve zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes.
- 4.4 Kuvendi i Komunës së Shtimes e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të Komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

Neni 6

Me këtë vendim do të njoftohen: Arkivi, Anëtarët e Komisionit, Drejtoria, MAPL-ja, dhe Zyra për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi